bistum st.gallen

sg.
kath.
ch

katholischer
konfessionsteil
des kantons
st.gallen

Mbrojtja për integritetin fizik, mendor dhe psikik

Qëllimi qendror i konceptit mbrojtës të dioqezës St.Gallen është mirëqenia dhe mbrojtja e njerëzve dhe e integritetit të tyre psikik, mendor dhe fizik. Për të mundësuar arritjen e këtij qëllimi u krijuan instrumentet dhe zyrat e nevojshme për parandalimin, përkrahjen dhe intervenimin. Konkretisht ato janë:

Ndihma për viktimat

Ndihma për viktimat është zyra e parë e kontaktit, e cila është e pavarur. **Ajo nuk është një institucion i kishës.** Konsultimet i nënshtrohen ruajtjes së sekretit, janë anonime dhe falas. Një kontaktim nuk ka ‹pasoja› si ngritja e një akuze ose lajmërimi tek zyra të tjera. Zyrat e ndihmës për viktimat i nënshtrohen obligimit të ruajtjes së sekretit.
Numri emergjent: 142, Kontakti: Ndihma për viktimat, E-Mail, Tel. 071 227 11 00

Zyra e lajmërimit

Zyra e lajmërimit është **zyra e kontaktit brenda kishës**. Ajo përkrah dhe shoqëron (posaçërisht) personin e cenuar dhe jep mbështetje në rastin e parashtrimit të kallëzimeve penale.
Në rastin e kontaktimit, zyra e lajmërimit është e obliguar, që të iniciojë një hetim të brendshëm në kishë, nëse bëhet fjalë për një rast dyshimi. Ai person, kush nuk dëshiron një hetim të tillë, nuk lajmërohet tek zyra e lajmërimit, por tek zyra “Ndihma për viktimat” apo tek zyra e kujdesit shpirtëror për persona të cenuar.
Kontakti: Zyra e lajmërimit

Kujdesi shpirtëror për persona të cenuar

Kujdestarët shpirtërorë janë në çdo kohë në dispozicion për biseda shoqëruese. Oferta është falas. Bisedat me kujdestarët shpirtërorë i nënshtrohen rreptësisht ruajtjes së sekretit dhe nuk pasohen nga hapat juridike. Kujdestarët shpirtërorë nuk janë kompetentë për procedura dhe ngritje akuzash. Kontakti: Kujdesi shpirtëror për persona të cenuar

Zyra e ndërmjetësimit

Zyra e ndërmjetësimit është një zyrë brenda Kishës Katolike, e cila punon në mënyrë këshilluese si dhe ndërmjetësuese. Ajo është në dispozicion të bashkëpunëtorëve dhe të personave të angazhuar vullnetarisht (p.sh. në raste bullizimi ose diskriminimi). Konsultimet i nënshtrohen ruajtjes së sekretit, janë anonime dhe falas.
Kontaktimi nuk pasohet nga lajmërime tek zyra të tjera.
Kontakti: Zyra e ndërmjetësimit

Zyra e hetimit

Zyra e hetimit sqaron çështje faktike. Ajo fillon me punën e saj pas lajmërimit të zyrës së lajmërimit ose pas porositjes nga ana e peshkopit. **Një lajmërim në zyrën e hetimit pasohet nga hapat juridike.**
Kontakti: Zyra e hetimit

Organizatat e personave të cenuar

IG-M!kU (Interessengemeinschaft Missbrauchsbetroffene im kirchlichen Umfeld) (në gjuhën gjermane)

bistum st.gallen

sg.
kath.
ch

katholischer
konfessionsteil
des kantons
st.gallen

Groupe SAPEC (Soutien aux personnes abusées dans une relation d'autorité religieuse) (në gjuhën franceze)
GAVA (Vittime di abusi in ambito religioso) (në gjuhën italiane)